

AKT THEMELIMI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

GastroFactory Shpk

Ne Tirane, sot me date 06 Tetor 2023 u mblodh Asambleja e Ortakeve te Shoqerise me prezencen e Ortakeve te **z. Elvin Tivari**, shtetas shoqiptar, i biri i Ismetit, lindur ne Durres, me 06 Mars 1978, banues ne Tirane, madhor me zotesi juridike per te vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet dokumentit te identifikimit me nr personal H803061290, **z.Redi Molla**, shtetas shoqiptar, i biri i Selimit, lindur ne Durres, me 03 Shkurt 1980, banues ne Tirane, madhor me zotesi juridike per te vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet dokumentit te identifikimit me nr personal I00203068U dhe **z.Dritan Kadiu**, shtetas shoqiptar, i biri i Eqeremit, lindur ne Durres, me 08 Gusht 1974, banues ne Durres, madhor me zotesi juridike per te vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet dokumentit te identifikimit me nr personal H40808055M te cilet me cilesine e "ortakeve themelues" redaktuan kete Akt Themelimi, nepemjet te cilit deklarojne se me vullnet te lire te plote e te sinqerte, dhe inisiativen e lire private, mbeshetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin nr 9901 date 14.04.2008, "Per Tregtarete dhe Shoqerite Tregtare", i ndryshuar me ligjin nr 129/2014 date 01.10.2014, ne ligjin nr 9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit", i ndryshuar me ligjin nr 131/2015 date 26.11.2015, ne legjislacionin Doganor, Fiskal e Tatimor, krijon shoqerine tregtare, me pergjegjesi te kufizuar "**GastroFactory Shpk**."

KREU I

Neni 1
Krijimi

1.1 Shoqeria, "**GastroFactory**" shpk. eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria").

Neni 2
Personaliteti juridik

2.1 Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi te jetë regjistruar në Qendren Kombetare te Biznesit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me legjislacionin Shqiptar ne fuqi.

2.2 Shoqeria, pasi te ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.


2.3 Shoqëria "**GastroFactory**" shpk., eshte nje e tille, kapitali i së cilës ndahet në pjese dhe që themelohet nga ortakët që përballon humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tij në kapitalin themeltar.

Neni 3
Selia

3.1 Shoqeria e ka seline ne Tirane ne Adresen: Rruga Sami Frasheri, Ndertesa 15, H 3; Njësia Administrative Nr. 5, Tiranë

3.2 Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojte filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me vendim te Ortakeve te Shoqerise.

Neni 4
Kohezgjatja



4.1 Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.

Neni 5
Objekti i veprimtarise

Objekti i veprimtarise se Shoqerise "**GastroFactory**" shpk. perfshin:

5.1 Aktivitet tregtar ne sektorin e Gastronomise, Bar-Resorant,

5.2 Ushtrimi i cdo lloj operacioni dhe transaksioni ne lidhje me importimin, eksportimin, tregetin, shitjen dhe shperndarjen e mallrave te nevojshme ne fushen e gastronomise produkteve te gatshme, ushqimore, industrial si dhe cdo aktivitet tjeter brenda kuadrit ligjor ne fuqi.

KREU II
KAPITALI

Neni 6
Kapitali themeltar dhe Pronesia

- 6.1 Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100 000 (njeqinde mije) lekë, i ndare në 3 (tre) pjesë.
6.2. Kapitali i Shoqerise zoterohet plotesisht nga ortaket themelues i ndare ne tre pjese me pjesemarrje:
6.2.a z. Elvin Tivari zoterues i 1(nje) pjese ose 34% te kapitalit te nenshkruar te shoqerise,
6.2.b z. Redi Molla zoterues i 1(nje) pjese ose 33% te kapitalit te nenshkruar te shoqerise,
6.2.c z. Dritan Kadiu zoterues i 1(nje) pjese ose 33% te kapitalit te nenshkruar te shoqerise,
6.3 Kapitali i mesiperm eshte nënshkruar dhe do te shlyet tërësisht ne te holla nga ortaket e shoqerise "**GastroFactory**" shpk, nepermjet transfertes bankare, pjese me vlere te pergjithshme 100 000 lekë, qe perbejne 100 % te kapitalit themeltar te shoqerise.
6.4 Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme dhe as me kontribute në shërbime.
6.5 Ortaket pergjigjen per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise;

Neni 7
Transferimi i kapitalit

- 7.1 Pjesët e kapitalit themeltar mund tu transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, vetëm me miratimin e Ortakeve te Shoqerise.
7.2 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie. Ato janë të transferueshme edhe në rast ndarjeje pasurore mes bashkëshortëve. Gjithashtu janë të transferueshme ndërmjet bashkëshortëve, si dhe ndërmjet paraardhësve dhe pasardhësve nepermjet akteve ligjore.

KREU III
ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8
Organi Vendimmarres

- 8.1 Asambleja e Ortakeve te Shoqerise eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.
8.2 Asambleja e Ortakeve te Shoqerise eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe

miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

8.3 Asambleja e Ortakeve te Shoqerise brenda një afati prej gjashtë muajsh, duke filluar nga data e mbylljes së vitit financiar, miraton raportin e administrimit, inventarin, bilancin dhe llogaritë vjetore, të hartuara nga administratorët,

8.4 Asambleja e Ortakeve te Shoqerise mund të përfaqësohet edhe nga një tjetër person, nepermjet prokures.

Neni 9
Ndryshimet e Statutit

9.1 Ndryshimet e statutit vendosen nga Asambleja e Ortakeve te Shoqerise.

9.2 Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 10
Administrimi

10.1 Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Asambleja e Ortakeve te Shoqerise te shoqerise.

10.2 Asambleja e Ortakeve te Shoqerise vendos per sistemin e administrimit, dhe ne rastin e nje organi administrativ me shume administratore, percakton numrin e tyre dhe kompetencat.

10.3 Administratori/ret, mund te jene ose jo ortake.

10.4 Administratori/ret mund te shkarkohet ne cdo kohe.

10.5 Shoqeria do te funksionoj me nivel nje Administratori

10.6 Administrator i shoqerise eshte:

10.6.a z. Elvin Tivari, shtetas shqiptar, i biri i Ismetit, lindur ne Durres, me 06 Mars 1978, banues ne Tirane, madhor me zotesi juridike per te vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet dokumentit te identifikimit me nr personal H803061290

10.7 Administratori i shoqerise do te ushtrojne kompetencat e tij ne kete detyre per nje periudhe 5 (pese) vjecare.

Neni 11
Kompetencat

11.1 Shoqëria administrohet nga nje Administrator. Administratori ka të drejte të kryejne të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm.

11.2 Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjithë personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve.

11.3 Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht Ortakeve te Shoqerise.

11.4 Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

11.5 Administratori ka gjithashtu të drejte të nënshkruaje kontrata të ndryshme në emër e për llogari te Shoqërisë, përfshi këtu kontratat e qirasë, shitjes, blerjes a hipotekimit të pasurive të paluajtshme, operacione financiare, të nënshkruajne aktet e themelimit të shoqërive të tjera ku Shoqëria është ortak, të nënshkruajne e hartojne çdo dokument e të kryejne në emër të Shoqërisë çdo veprim përballë të gjitha Bankave shqiptare apo te huaja në lidhje me çeljen apo mbylljen e llogarive rrjedhëse te Shoqërisë, nënshkrimin e kontratave te ndryshme bankare për financimin e Shoqërisë si dhe te kryeje veprime tërheqje e derdhje shumash nga këto llogari pa limit.

11.6 Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

11.7 Klauzolat e këtij Akt Themelimi që kufizojnë kompetencat e administratoreve, të cilat rrjedhin nga ky nen, duhet të respektohen nga të tretët.

11.8 Administratori ose Ortaku që nuk janë persona juridikë nuk u lejohej të kontraktojnë në çfarëdolloj forme qoftë, të marrin hua te shoqëria, të japin pëlqimin në emër të saj, për paradhënie si dhe të bëhen dorëzënës apo të garantojnë në emër të saj angazhimet ndaj të tretëve. Në rast të kundërt kontrata është e pavlefshme.

Neni 12
Viti Financiar

12.1 Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor.

12.2 Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërisë ne QKB dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 13
Shpërndarje, Likuidimi ose Prishja e Shoqërisë

13.1 Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet ne cdo kohe dhe per cfaredo shkak, edhe para plotesimit të afatit per të cilin është krijuar sic mund të jone :

13.2.a Humbja e kapitalit ose pamundësia e vazhdimit të metejshëm të veprimtarisë se saj.

13.2.b Ne nje nga menytrat e parashikuara nga ligji " Per Falimentimin e Shoqërive Tregtare"

13.2.c Kur plotesohet afati i caktuar per ushtrimin e veprimtarisë tregtare.

13.3 Ne kete rast Ortaket e Shoqërisë marrin vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1(nje) apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese " Shoqëri ne likuidim e siper ".

Neni 14
Baza Ligjore

14.1 Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

14.2 Per sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik ne Republikën e Shqipërisë qe ka lidhje me objektin e veprimtarisë se shoqërisë.

Neni 15
Dispozita përfundimtare


15.1 Ky akt themelimi u redaktua ne 4 ekzemplare me permbajtje dhe vlera te njejtë juridike, ne gjuhen shqipe dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaket themelues te shoqërisë "**GastroFactory**" shpk., nenshkruset ne të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen e tyre orgjinale, autenticiteti i të cilit vertetohet nga dokumenti i identifikimit ketu bashkengjitur.

ORTAKET

z.Elvin Tivari



z.Redri Molla



z.Dritan Kadiu

